



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshtor

Seanca plenare e Kuvendit
P-07
Prishtinë, më 29 dhjetor 2014

P R O C E S V E R B A L

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 29 DHJETOR 2014**

Seancën e kryesoi Kadri VESELI, kryetar i Kuvendit, ndërsa i ndihmoi Xhavit HALITI, nënkryetar.

Kryetari i deklaroi të hapura punimet e seancës plenare dhe konstatoi se në sallë janë të pranishëm 93 deputetë.

Ai procedoi me rendin e ditës në pajtim me vendimin e Kuvendit, nr. 05-V-006, të datës 22 dhjetor 2014.

Në vazhdim, lidhur me rendin e ditës, për fjalë u paraqit deputeti Ismet Beqiri.

Ismet Beqiri, në emër të GP të LDK-së, propozoi që për rendin e ditës së punimeve të mbledhjes së sotme të shqyrtohet pika: Propozim-vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për zgjatjen e periudhës kalimtare të lirimeve nga Tatimi i Vlerës së Shtuar për importe dhe për furnizim me mallra nga data 1 janar 2015 deri më 31 dhjetor 2015.

Në lidhje me propozimin e deputetit Ismet Beqiri, kryetari kërkoi deklaratimet e grupeve parlamentare.

Për propozimin e lartpërmendur, u deklaruan deputetët: Adem Grabovci, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes "Vetëvendosje"; Donika Kadaj-Bujupi, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Jasmina Zhivkoviq, në emër të Grupit Parlamentar LS dhe Jakup Krasniqi, në emër të Grupit Parlamentar "Nisma", diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Në vazhdim, kryetari hodhi në votim propozimin e paraqitur nga deputeti Ismet Beqiri.

Rezultati i votimit ishte:

Për ----- 65,
Kundër ----- 30,
Abstenime ----- 1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi miratoi propozimin që pika: Propozim-vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për zgjatjen e periudhës kalimtare të lirimeve nga Tatimi i Vlerës së Shtuar për importe dhe për furnizim me mallra nga data 1 janar 2015 deri më 31 dhjetor 2015, të renditet si pikë e dytë e rendit të ditës për seancën e sotme plenare.

* * *

Në vazhdim Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015,
2. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për zgjatjen e periudhës kalimtare të lirimeve nga Tatimi i Vlerës së Shtuar për importe dhe për furnizim me mallra nga data 1 janar 2015 deri më 31 dhjetor 2015.

* * *

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015

Në fillim të shqyrtimit të pikës së lartpërmendur të rendit të ditës për diskutim u paraqit deputetja Albulena Haxhiu, kryetare e Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit.

Deputetja Albulena Haxhiu tha se pika nr. 2 e vendimit nr. 05-V-006 të seancës plenare të datës 22 dhjetor 2014 është në kundërshtim me Rregulloren e Kuvendit, sepse janë anashkaluar tri komisionet e përhershme parlamentare, të cilat janë të detyruara ta shqyrtojnë projektligjin.

Deputetja Albulena Haxhiu, në vazhdim tha se edhe në të kaluarën Kuvendi ka votuar për shmangie të Rregulloreve për shqyrtimin e projektligjeve të ndryshme, mirëpo asnjëherë nuk janë anashkaluar komisionet e përhershme.

Ajo më tej theksoi se sot, më 29 dhjetor 2014, komisioni që ajo drejton e ka mbajtur mbledhjen e vet dhe me shumicë votash kemi vendosur që t'i propozojmë seancës plenare që ta shqyrtojmë Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015.

Ajo propozoi që fillimisht komisionet e përhershme ta shqyrtojnë Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015 dhe më pas seanca plenare t'i vazhdojë punimet.

Fjala e deputetes Albulena Haxhiu është dhënë e plotë në transkript.

Në vazhdim, lidhur me këtë çështje diskutuan: Adem Grabovci, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Ismet Beqiri, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Donika Kadaj-Bujupi, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Myfëra Shinik, në emër të Grupit Parlamentar “6+”, si dhe deputetët:

Melihate Tërmmkolli, Armend Zemaj, Vjosa Osmani, Donika Kadaj-Bujupi, Jakup Krasniqi, Sabri Hamiti dhe Ilir Deda, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Adem Grabovci, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, propozoi një pauzë të seancës deri më orën 14:00 dhe në ndërkohë tri komisionet tjera të përhershme ta shqyrtojnë Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015.

Kryetari e hodhi në votim propozimin e lartpërmendur të deputetit Adem Grabovci.

Rezultati i votimit ishte:

Për ----- 68,

Kundër ----- 0,

Abstenime ----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

1. Ngarkohet Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim dhe Komisioni për Integritet Evropian që ta shqyrtojnë Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015 dhe

2. Komisioni për Buxhet dhe Financa, në bazë të raporteve të komisioneve nga paragrafi 1 (një) i këtij vendimi, t'ia paraqesë Kuvendit raportin me rekomandime.

Kryetari dha pauzë deri në orën 14:00.

* * *

Pas pauzës, kryetari procedoi me pikat e rendit të ditës, si në vijim:

Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015

Kryetari i njoftoi deputetët se komisionet e parlamentare, në pajtim me vendimin e Kuvendit Nr. 05-V-008, të datës 29 dhjetor 2014, e kanë shqyrtuar Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015 dhe Kuvendit i kanë paraqitur raportet me rekomandime.

Raportin e Komisionit për Buxhet dhe Financa e paraqiti dhe e arsyetoi kryetari i këtij komisioni, Naser Osmani.

Raportin e Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit e paraqiti dhe e arsyetoi kryetarja e këtij Komisioni, Albulena Haxhiu.

Raportin e Komisionit për Integritet Evropian e paraqiti dhe e arsyetoi kryetarja e këtij Komisioni, Teuta Sahatqija.

Ndërsa deputetja Donika Kadaj-Bujupi foli në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, kurse deputeti Kujtim Paçaku në emër të Grupit Parlamentar “6+”, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari i hodhi në votim amendamentet e propozuara, një nga një.

Kuvendi i miratoi amendamentet: 1, 2, 3, 4, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 36, 37, 38, 39, 40, 61 dhe amendamentin nr. 63.

Deputeti Nait Hasani, kryetar i Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport, i tërhoqi amendamentet me numrat: 46, 47, 48, 49 dhe 50.

Ministri i Financave, Avdullah Hoti, e tërhoqi amendamentin nr. 51.

Deputetja Alma Lama e tërhoqi amendamentin nr. 57.

Deputetja Vjosa Osmani e tërhoqi amendamentin nr. 64.

Kuvendi nuk i miratoi amendamentet: 5, 41, 42, 43, 44, 45, 52, 53, 54, 55, 56, 58, 59, 60 dhe amendamentin nr. 62.

Deputeti Besnik Bislimi diskutoi në lidhje me amendamentet me numër: 5, 58 dhe 60.

Në lidhje me amendamentin nr. 13 diskutuan: ministri Mahir Yagcilar dhe deputetët Naser Osmani dhe Zenun Pajaziti.

Në lidhje me amendamentin nr. 22 diskutuan deputetët: Naser Osmani, Alma Lama, Emilija Rexhepi, Danush Ademi dhe Ismajl Kurteshi.

Në lidhje me amendamentin nr. 32 diskutoi deputetja Shqipe Pantina.

Në lidhje me amendamentin nr. 35 diskutuan: Armend Zemaj, Naser Osmani, Daut Haradinaj, Adem Grabovci, Rustem Berisha, Ismet Beqiri, Shpejtim Bulliqi, Donika Kadaj-Bujupi, kryeministri Isa Mustafa, Armend Zemaj, ministri Avdullah Hoti, Time Kadrijaj, Latif Gashi, Salihe Mustafa, Safete Hadërgjonaj, Zafir Berisha, Shaip Muja, Muhamet Mustafa dhe Hajdar Beqa.

Në lidhje me amendamentin nr. 41 diskutuan deputetët: Naser Osmani, Shaip Muja dhe Emilija Rexhepi.

Në lidhje me amendamentin nr. 42 diskutoi deputeti Besim Beqaj.

Në lidhje me amendamentin nr. 43 diskutuan: Donika Kadaj-Bujupi, ministri Avdullah Hoti, Latif Gashi, Shaip Muja dhe kryeministri Isa Mustafa.

Në lidhje me amendamentin nr. 44 diskutoi deputeti Rustem Berisha.

Në lidhje me amendamentin nr. 45 diskutoi deputeti Bali Muharremaj.

Në lidhje me amendamentin nr. 50 diskutuan: zv/kryeministri Kujtim Shala, Bekim Haxhiu, Naser Osmani, Latif Gashi, Sali Morina, Zafir Berisha, Armend Zemaj, kryeministri Isa Mustafa, Bekim Bislimi, Safete Hadërgjonaj dhe ministri Hajredin Kuçi.

Në lidhje me amendamentin nr. 51 diskutuan: ministri Avdullah Hoti, Visar Ymeri dhe Besim Beqaj.

Në lidhje me amendamentin nr. 52 diskutuan deputetët: Faton Topalli dhe Ismet Beqiri.

Në lidhje me amendamentin nr. 53 diskutoi deputeti Nait Hasani,

Në lidhje me amendamentet nr. 54, 55 dhe 56 diskutoi deputeti Salih Salihu.

Në lidhje me amendamentin nr. 59 diskutuan deputetët: Bekim Bislimi dhe Shaip Muja.

Në lidhje me amendamentin nr. 61 diskutuan: Shukrije Bytyçi, Sali Morina, Nait Hasani, Shaip Muja, Naser Osmani, Adem Grabovci, Time Kadrijaj, ministri Avdullah Hoti, Sala Berisha-Shala, Haxhi Shala, Salihe Mustafa, Blerta Deliu-Kodra, Valdete Bajrami, Faton Topalli, Bekim Bislimi dhe Bekim Haxhiu.

Në lidhje me amendamentin nr. 62 diskutuan deputetët: Shukrije Bytyqi dhe Ali Sadriu.

Në lidhje me amendamentin nr. 63 diskutuan deputetët: Vjosa Osmani, Naser Osmani, Ismajl Kurteshi, Flora Brovina, Armend Zemaj, Latif Gashi, Selville Halimi, Shukrije Bytyçi, Time Kadrijaj dhe Muhamet Mustafa.

Diskutimet e deputetëve, e kryeministrit dhe e ministrave lidhur me amendamentet e lartpërmendura janë dhënë të plota në transkript.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim miratimin e Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015, me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 69,
Kundër ----- 20,
Abstenime ----- 3.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, e miratoi Ligjin nr. 05/L-001 për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2015.

2. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për zgjatjen e periudhës kalimtare të lirimeve nga tatimi i vlerës së shtuar për importe dhe për furnizim me mallra nga data 1 janar 2015 deri më 31 dhjetor 2015

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni Funkcional për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar Propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për zgjatjen e periudhës kalimtare të lirimeve nga Tatimi i Vlerës së Shtuar për importe dhe për furnizim me mallra nga data 1 janar 2015 deri më 31 dhjetor 2015 dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

Raportin me rekomandime, në emër të Komisionit Funkcional për Buxhet dhe Financa, e paraqiti dhe arsyetoi kryetari i këtij komisioni, Naser Osmani.

Pastaj, kryetari hapi diskutimet lidhur me këtë pikë të rendit të ditës.

Në vazhdim diskutuan deputetët: Alma Lama, Bekim Bislimi dhe Zafir Berisha, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryetari e hodhi në votim miratimin e Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për zgjatjen e periudhës kalimtare të lirimeve nga Tatimi i Vlerës së Shtuar për importe dhe për furnizim me mallra nga data 1 janar 2015 deri më 31 dhjetor 2015.

Rezultati i votimit ishte:

Për ----- 63,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 4.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, e miratoi Propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për zgjatjen e periudhës kalimtare të lirimeve nga tatimi i vlerës së shtuar për importe dhe për furnizim me mallra nga data 1 janar 2015 deri më 31 dhjetor 2015.

* * *

Në fund, kryetari i njoftoi deputetët se, në pajtim me nenin 37 të Rregullores së Kuvendit, Kuvendi i përmbyll punimet e Sesionit vjeshtor, ndërsa punimet e Sesionit pranveror i fillon të hënën e tretë të muajit janar 2015.

Kryetari i mbylli punimet e seancën plenare në orën 20:30 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale